



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 01, datë 03.09.2019

PËR

PËR ZGJERIMIN E SIPËRFAQES SË PARKUT KOMBËTAR “MALI I TOMORIT”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 81, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”; VKM-së Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 57, datë 06.02.2019 “Për kriteret dhe mënyrën e zonimit të territorit të një zone të mbrojtur mjedisore”, me propozim të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Zgjerimin e sipërfaqes së Parkut Kombëtar “Mali i Tomorit”, me një sipërfaqe prej 1383 (një mijë e treqind e tetëdhjetë e tre) ha, sipas hartës dhe kufijve bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Nga ky zgjerim i kufirit Parku Kombëtar “Mali i Tomorit” do të ketë një sipërfaqe totale prej 26106.2743 (njëzet e gjashtë mijë e njëqind e gjashtë pikë dymijë e shtatëqind e dyzetë e tre) ha.
3. Sipas zonimit, sipërfaqja e shtuar bën pjesë në zonën e përdorimit tradicional (ZPT), ku zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes.
4. Çdo dokument planifikimi në fuqi, që bie ndesh me këtë vendim, duhet të ndryshohet në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe autoritetet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, që preken nga ky vendim.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

